



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI
REKTORI

Nr. 1436 prot.

Tiranë më 16/10/2025

VENDIM

Nr. 12, datë 16.10.2025

**“PËR SHPALLJEN E PERIUdhës ZGJEDHORE DHE DATËS SË ZGJEDHJEVE
PËR ANËTARË TË KËSHILLIT STUDENTOR TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE”**

Në zbatim të Ligjit nr. 80/2025 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 39 dhe neni 99, pika 1 dhe 3, Statutit të Universitetit të Arteve, neni 130 si dhe Rregullores së Zgjedhjeve për Këshillin Studentor, neni 5, pas shqyrtimit dhe përcaktimit të periudhës zgjedhore dhe datës së zgjedhjeve,

VENDOSA:

1. Të shpall periudhën **20 tetor 2025 – 20 nëntor 2025**, si periudhën zgjedhore për anëtarë të Këshillit Studentor të Universitetit të Arteve. Brenda kësaj periudhe duhet të respektohen të gjitha afatet e nevojshme për krijimin e komisioneve përkatëse dhe zhvillimin e fushatës zgjedhore studentore.
2. Të shpall datën **21 nëntor 2025**, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për anëtarë të Këshillit Studentor të UART.
3. Zgjedhjet studentore do të zhvillohen në përputhje me Rregulloren për Zgjedhjet e Këshillit Studentor në Universitetin e Arteve, miratuar me Vendim të Senatit Akademik nr. 26, dt. 24.05.2023.
4. Vendimi i përcillet për zbatim Njërive Kryesore të UART, të cilat duhet të përzgjedhin dhe shpallin me vendim të Dekanit anëtarët përfaqësues të Komisionit Institucional Zgjedhor Studentor (KIZS) si dhe 1 (një) përfaqësues për pozicionin e sekretarit, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e shpalljes së periudhës zgjedhore. Përzgjedhja bëhet nga listat e studentëve të vetëkandiduar, të cilët regjistrohen në sekretarinë mësimore të fakultetit përkatës.
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë si dhe të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit.

REKTOR

Prof. Dr. Erald Bakalli